

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Energjisë, Shkurt 2025

15.04.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon “Statistikat e Energjisë” për muajin shkurt 2025 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

Rritet konsumi i energjisë elektrike në shkurt 2025, krahasuar me shkurt 2024

Gjatë muajit shkurt të vitit 2025, energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 776.64 GWh, ndërsa konsumi i energjisë elektrike ishte 536.32 GWh, që paraqet një rritje prej 12,86%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 5,76%.

Ndërkaq, importi i energjisë elektrike në shkurt të vitit 2025 ishte 374.94 GWh, ndërsa eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 132.32 GWh (këtu përfshihen edhe sasitë e transmetimit).


Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 658.12 mijë ton që paraqet një rritje prej 1,43%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Pasqyra e prodhimit, konsumit dhe raporti i energjisë elektrike

shkurt 2024 / shkurt 2025

Energjia Elektrike MW/h	02-2024	02-2025	Ndryshimi në përqindja
Prodhimi Bruto nga Termocentralet	567,874	503,113	-11.40%
Prodhimi Bruto nga Hidrocentralet	17,664	13,287	-24.78%
Prodhimi Bruto nga Era dhe ajo Solare	44,203	17,630	-60.12%
Importi	300,604	374,937	24.73%
Eksporti	266,639	132,322	-50.37%
Energjia Elektrike bruto në Dispozicion	663,707	776,645	17.02%
Amvisnia	297,634	339,583	14.09%
Komercial	112,165	128,808	14.84%
Industri	44,646	48,436	8.49%
Ndriqimi publik & tjerat	3,627	4,127	13.77%
Konsumatorët 220-110kv	8,040	5,761	-28.34%
Mihjet	9,110	9,609	5.48%
Konsumi i energjisë Elektrike	475,222	536,324	12.86%

Struktura e konsumit të energjisë elektrike Shkurt 2025



Për më shumë informata lidhur me publikimin e Statistikave të Energjisë në Kosovë, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/Energy>